

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија” бр. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ 96/19 и 110/19) како и врз основа на член 22 и член 25 од Законот за средно образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/18) министерот за образование и наука донесе скратена наставна програма по наставниот предмет **Албански јазик и литература за II (втора) година на средното гимназиско образование за учебната 2020/2021 година.**



**PROGRAM I SHKURTUAR
MËSIMOR**

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
Viti II

Shkup 2020/2021

Arsimi gjimnazor

1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi bazohet në rezultatet e pritura të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore **Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e dytë të arsimit gjimnazor** që rregullisht realizohet në akordim me Planin mësimor. Me programin e shkurtuar përcaktohen tema dhe njësi mësimore të caktuara që duhet të realizohen për **159** ditë mësimore me ç'rast merret parasysh fondi javor i parashikuar i orëve i përcaktuar në programin e rregullt, gjegjësisht për këtë lëndë mësimore në akordim me **4** orët në javë të parashikuara në programin e shkurtuar mësimor duhet të parashikohen **128** orë të ndara barazisht në fushën programore Gjuhë dhe fushën programore Letërsi.

Msimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet prej rezultateve të arritura, nocioneve të përcaktuara, metodat dhe aktivitetet të verifikuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyrimi i temave dhe njësive mësimore

Nr.re-ndor	Fusha programore Gjuhë Njësitë mësimore	Numri i orëve të propozuara për realizim
1.	LEKSIKOLOGJI- Fjala si njësi bazë e leksikut- Kuptimi leksikor i fjalës	5
2.	Sinonimet,antonimet,homonimet-arkaizmat,historizmat, dialektizmat, krahinizmat,neologjizmat, profesionali...	6
3.	Njësitë frazeologjike- Fjalorët – llojet e tyre	4
4.	MORFOLOGJI-Mbiemri dhe shkallët e mbiemrit	3
5.	Përemrat- Përemrat vetorë- Përemrat dëftorë- Përemrat pronorë	3
6	Përemrat pyetës- Përemrat lidhorë- Përemrat e pacaktuar	3
7	Pjesët e pandryshueshme të ligjeratës:Ndajfolja, parafjala, pasthirrma	3
8	Lidhëzat me bashkërenditje dhe nënrenditje	2
9	SINTAKSË-Fjala e thjeshtë dhe e përbërë	3
10	Ndajshtimi	2
11	Rrethanorët	3
12	KOMUNIKIM-Komunikimi dhe shkrimet funksionale	3
13	Katër hartime me shkrim	8
14	Përsëritje	11
	Numri i tërësishëm i orëve të realizuara nga fusha programore Gjuhë	59

Nr.ren- dor	Fusha programore Letërsi Njësitë mësimore	Numri i orëve të proponuara për realizim
1	Letërsia shqipe- Letërsia e Rilindjes Kombëtare	2
2	Jeronim de Rada-"Këngët e Milosaos"...	2
3	Gavrill Dara i Riu-"Kënga e sprasme e Balës"...	2
4	Zef Serembe- Poezia lirike e tij	1
5	Anton Santori-"Emira"	2
6	Naim Frashëri-"Lulet e verës", "Bagëti e bujqësi"	3
7	Sami Frashëri-"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?"	2
8	Pashko Vasa-"Bardha e Temalit", "O moj Shqypni"	3
9	Ndre Mjeda-"Juvenilja".	3
10	Andon Z. Çajupi- #Baba Tiomorri"- "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndërr",..	3
11	Aleks S. Drenova--"Rreze dielli"	3
12	Zef Skiroi- "Rapsodie Albanese"- "Te dheu i huah"	2
13	Ndoc Nikaj	2
14	Letërsia Botërore-Renesansa- Dante Aligieri-"Komedia hyjnore"	2
15	Miguel de Servantes-,,Don Kishoti i Mançës"	2
16	Klasicizmi-Zhan Rasin-"Andromaka"	2
17	Zhan B.Molier- komedia "Tartufi"	2
18	Romantizmi - Johan V. Gëte-"Fausti"	3
19	Viktor Hygo- "Të mjerët"	2
20	A.S.Pushkin-,,Eugjen Onjegin"	2
21	Xhorxh. G. Bajroni- "Çajld Harold"	3
22	Lektyrë – Të përpunohen gjashtë lektyra në përzgjedhjen e mësimdhënës të bashku me nxënësit	6
23	Përsëritje	13
	Numri i tërësishëm i orëve të realizuara nga fusha programore Letërsi	69

3. Rekomandime didaktike

Propozim programi i shkurtuar për lëndën mësimore Gjuhë shqipe dhe letërsi për arsimimin gjimnazor për vitten e dytë është i akorduar me nevojat për realizimin e mësimi me numër më të vogël të ditëve mësimore në akordim me kushtet dhe i ndarë në dy fusha programore: gjuhë dhe letërsi.

Nëpërmjet **fushës programore Gjuhë**, aftësitë dhe shkathtësitë komunikimit, kryesisht duhet të ushtrohen dhe praktikohen në formën e folur dhe të shkruar, përmes formulimeve të sakta gjuhësore dhe respektimit të rregullave gramatikore të gjuhës standarde (letrare) moderne. Përdorni tekste përmes të cilave shprehen funksionet e gjuhës dhe ushtrime duke krahasuar shembuj nga gjuhë të ndryshme me gjuhën shqipe. Përdorni tekste me shembuj të funksioneve të ndryshme të gjuhës me prezantime audio-vizuale të funksioneve të shenjave në pikëpamje të ndryshme artistike. Përveç teksteve, regjistrimet e tingujve mund të përdoren me shembuj që ilustrojnë ndryshimet midis të folmeve popullore dhe gjuhës standarde, ushtrime për shndërrimin e tekstit dialektor në standard dhe anasjelltas, fotografi për krahasimin e llojeve të shkronjave, si dhe shembuj të ideogrameve moderne dhe gjuhës së tyre etj. t'i njohin njësitë frazeologjike brenda teksteve të ndryshme dhe të aftësohen të përdorin fjalorin e gjuhës së sotme shqipe. Gjatë realizimit të njësive mësimore nga leksikologjia, përveç tjerash, nxënësit duhet t'i njohin njësitë frazeologjike brenda teksteve të ndryshme dhe të aftësohen të përdorin fjalorin e gjuhës së sotme shqipe. Realizimin e njësive mësimore nga morfologjia, Mbiemri dhe shkallët e mbiemrit, Përemrat dhe llojet e përemrave etj., analizoni dhe krijoni ushtrime me shembuj prej teksteve të ndryshme nëpërmjet të cilëve nxënësit mundet t'i zgjerojnë dituritë e arritura për përemrat, mbiemrat dhe foljet. E njëjta kërkesë vlen edhe për njësitë mësimore nga sintaksa.

Përmbajtjet nga fusha programore Letërsi vendoseni sipas rezultateve të prashikuara duke i ndërlidhur standardet për notimin e të arriturave me qëllim që të përfitoni përmbajtje nëpërmjet të cilave nxënësit do t'i aftësoni të lexojnë, kuptojnë dhe interpretojnë duke fituar dituri të cilat do t'i praktikojnë në tekstet artistike dhe jo artistike. Në të vërtetë, fusha programore letërsi, përmes rezultateve të nxjerra nga të mësuarit kërkon nga nxënësi t'i gjejnë, t'i njohin dhe t'i klasifikojnë llojet e teksteve, t'i interpretojnë dhe vlerësojnë ato. Poashtu, në tekstet ata duhet t'i njohin informacionet të cilat do të u ndihmojnë jo vetëm në përkufizimin e faktetve të veçanta për ngjarjet, kohën dhe vendin, por edhe për informacionet dhe cilësitë e personazheve, mjeteve stilistike, elementet nga vepra që do t'i udhëzojnë në epokë ose drejtimin stilistik së cilës i përket vepra. Përmbajtjet në fushën programore Letërsi realizoni përmes teksteve, shembujve dhe ushtrimeve të përshtatshme që do t'u japin mundësi nxënësve të lexojnë, kuptojnë, interpretojnë dhe klasifikojnë, krahasojnë ngjashmëritë dhe njohin dhe dallimet. Gjatë mësimi të drejtimeve në art dhe letërsi përdorni fotografi, të dhëna enciklopedike të asaj periudhe në mënyrë që nxënësit të mund të shohin ndryshimet e përgjithshme në botëkuptimeve në Europë. Prej arsimtarëve pritet për secilën njësi mësimore në fazën e planifikimit dhe shkrimit të përgatitjes për orën e mësimi, t'i definon rezultatet e të nxënit për orën mësimore që çojnë në realizimin e qëllimeve të përcaktuara nga programi dhe të jetë sa më konkret. Pjesa e programit të që ka të bëjë me komunikimin praktik profesional duhet të jetë sa më e konkretizuar. Gjatë planifikimit duhet patur kujdes pasi rezultatet e të nxënit ndryshojnë. Disa prej tyre mund të arrihen më shpejtë dhe më lehtë, por shumica prej tyre kërkojnë më shumë kohë dhe aktivitete të ndryshme.

Strategjitë e të mësuarit:

-Strategjia e të menduarit kritik (përforcimi i të menduarit kritik gjatë të mësuarit e një lënde ose problemi përkatës, sjelljen e përfundimeve pas analizës së provave-citateve, krahasim);

-strategji (shpjeguese) përshkuese (aftësimi i nxënësve për të përcjellë informacionin në mënyrë të shkurtër dhe të qartë, duke krahasuar me atë që ata tanimë e dinë me atë që dëgjojnë, duke kuptuar atë që e mësojnë dhe zbatimin e saj).

Propozim metodat dhe teknikat për realizimin e orëve – shfrytëzoni teknika/mënyra të cilat nuk iu marrin kohë për realizim, por janë efektive dhe me këtë do të keni orë në të cilën do të ketë lëvizje dhe do të keni edhe kohë për sintezë.

Numri i orëve të propozuara në këtë program të shkurtuar sipas përmbajtjeve nuk është i fiksuar. Prandaj, sipas nevojës, momentit dhe kushteve mund të bëni ndryshimin e numrit të orëve por jo edhe ta kaloni totalin e **128** orëve të këtij programi.

Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon arsimtari në akordim me normativin për kuadër mësimor i dhënë në në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor **Gjuhë shqipe dhe letërsi për vitin e dytë të arsimit gjimnazor** e miraton:

Скратената наставна програма по наставниот предмет **Албански јазик и литература за II (втора) година на средното гимназиско образование** ја донесе

Бр.12-8424/97

16.09.2020

Министер за образование и наука

Мила Царовска